

A K T – T H E M E L I M I
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
WEBLO Sh.p.k

Sot më datën 25/01/2023 në orën 13:00 e nenshkruara ZNJ. ORKIDA GOGA, shtetase shqiptare, bija e ANDON , lindur në Fier më 09/01/1990 e banues në Tirane, mbajtës i kartes se identitetit J05109068M, ne titullin e ortaku i vetem themelon një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar duke u mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në Kodin Civil, në ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” si dhe në ligjet e dispozitat e tjera në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 1

Emërtimi

Shoqëria, e cila më poshtë në këtë akt do të quhet shkurtimisht “shoqëria”, do të marrë emërtimin **WEBLO Sh.p.k.** dhe është person juridik i të drejtës shqiptare.

NENI 2

Objekti i shoqërisë

Shoqëria ka për objekt:

*Ofrimin e shërbimeve në fushën e marketingut si dhe të çdo aktiviteti mbështetës apo ndihmës të kërkuar nga klientët apo nga tregu;

*Teleshitjet (*teleselling*):

*Shoqëria ka si objekt te veprimtarise se saj kryerjen e transaksioneve me tituj dhe vecanerisht blerjen dhe shitjen e titujve me porosi te klientit dhe veprimtarine e keshillimit te veprimtarise me tituj. Gjithashtu shoqëria mund te kryeje çdo aktivitet tjeter plotesues dhe ndihmes qe ka si qellim ofrimin e cdo sherbimi tjeter dhe kryerjen e cdo aktiviteti tjeter, ne rast se rezultojne te dobishme dhe/ose te nevojshme per permbushjen e objektit kryesor. Shoqëria mund te marre pjese ne menyre te drejtperdrejte ose terthorte ne cdo shoqëri qe ka objekt te ngjashem apo qe lidhet me objektin e shoqërise. Per kete qellim, shoqëria mund te bashkepunoje me, ose ne cdo menyre tjeter, te drejtperdrejte ose terthorte, te marre pjese ne shoqëri te tjera qe kane objekt te ngjashem ose qe kane lidhje me objektin e shoqërise ose ndihmes per realizimin e objektit te shoqërise.

*Planifikimin dhe zbatimin në emër dhe për llogari të saj si dhe të palëve të treta, të kërkimeve dhe përpunimeve statistikore të çdo lloji, të kërkimit dhe studimit të tregut nëpërmjet intervistave apo mënyrave të tjera, duke përfshirë edhe të dhënat e njohura deri tani, e që do të kryhen edhe duke përdorur teknika të bazuara mbi teknologji dhe instrumente informatike dhe telematike;

*Administrim dhe nënkontraktim (*outsourcing*), për llogari të klientëve të vet, të veprimtarive administrative e tregtare dhe të marëdhënieve me klientelën, e që do të kryhen edhe duke përdorur teknika të bazuara mbi teknologji dhe instrumente informatike dhe telematike;

*Rimarrje e mbledhje kreditesh që do të kryhen edhe duke përdorur teknika të bazuara mbi teknologji dhe instrumente informatike dhe telematike;

*Kryerje punimesh informatike “me çelsa në dorë”; planifikim dhe zbatim punimesh software të përshtatura dhe me porosi; ndihmë dhe shërbim mirëmbajtjeje për hardware dhe software;

*Organizim takimesh e mbledhjesh, seminaresh dhe kongresesh;

*Kurse përgatitjeje profesionale.

Të gjitha shërbimet e lartpërmendura mund të zhvillohen si në tregun e brendshëm, ashtu dhe në tregun e jashtëm.



Shoqëria mund të angazhohet gjithashtu në çfarëdo lloj aktiviteti tjetër që nuk ndalohet me ligj.

NENI 3

Selia

Shoqëria do ta ketë selinë në Tiranë, Rruga Dervish Hima, Kulla "Ada Center", Zyra kati 0, por me vendim të ortakëve mund të hapë degë, agjenci dhe zyra përfaqësimi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë tij.

NENI 4

Kohëzgjatja

Shoqëria do ta zhvillojë veprimtarinë e saj për një kohëzgjatje të pacaktuar.

NENI 5

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100. (njëqind) lekë dhe është i ndarë në 1 (nje) kuote me vlerë nominale 100 (njëqind) lekë. Ky kapital themeltar është i nënshkruar dhe i derdhur tërësisht me para.

NENI 6

Administrimi

Shoqëria, do të administrohet nga ZNJ **ORKIDA GOGA** i cili ka të drejta për të vepruar në marrëdhënie me të treta në emër të shoqërisë, në përjashtim të kompetencave që ligji ju jep shprehimisht ortakëve.

NENI 7

Viti financiar

Viti financiar i veprimtarisë ekonomike (duke përfshirë edhe këtë vit) mbyllet më 31 dhjetor të çdo viti.

NENI 8

Për çdo gjë që nuk është parashikuar në këtë akt themelimi, do të zbatohen dispozitat që përmbahen në Statutin e shoqërisë, Ligjet në fuqi si dhe në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë.

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij akti themelimi, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë ndërmjet shoqërisë dhe të tretëve, kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata shqiptare.

Ky Akt Themelimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar **WEBLO** sh.p.k. hartohet në 3 (kopje) kopje të njëjta në gjuhën shqipe, pasi lexohet me miratohet dhe u nënshkrua nga ortaku.

Ortakët themelues:

WEBLO sh.p.k

ORKIDA GOGA

Orkida Goga

